



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni pranveror

Komisioni për Ekonomi, Tregti, Industri, Energjetikë, Transport dhe Telekomunikacion

Mbledhja nr. 09/2009

Më 17. 03. 2009, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-10

Procesverbal

Në mbledhje morën pjesë: Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit, Ethem Çeku, Haki Shatri, Safete Hadergjonaj, Fatmir Rexhepi, Berim Ramosaj dhe Sala Berisha – Shala.

Munguan: Slobodan Petroviq, Zef Morina dhe Kaqusha Jashari.

Pjesëmarrës të tjerë: Izer Arifi, Remzije Hajdari dhe Naser Grajçevci - MTI;
Blerina Uka - NDI; Haxhi Gashi - USAID dhe Ramadan Klisurica - KDI.

Nga Zyra Mbështetëse: Hasan Tahiri, Advije Morina, Armend Ademaj dhe Besim Haliti.

Mbledhjen e drejtoi Myzejene Selmani - kryetare e Komisionit.

Rendi i ditës

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10. 03. 2009;
3. Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping;
4. Shqyrtimi i Projektligjit për zonat ekonomike;
5. Të ndryshme.

I. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

II. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së 10. 03. 2009

Procesverbali i mbledhjes së 10. 03. 2009 u miratua pa vërejtje.

III. Shqyrtimi i Projektligjit për masat antidamping

Kryetarja – Meqë përpara i kemi dy shkresa për Komisionin, gjegjësisht për MTI-në dhe USAID-in, për këtë projektligj, kërkoj nga të dy institucionet t’i paraqesin komentet e veta.

Safete Hadergjonaj – Në pajtim me rregullën 44.9 të Rregullores së Kuvendit është dashur të jetë i pranishëm ministri ose zëvendësi i tij, prandaj nuk është e arsyeshme të diskutohet më kjo pikë. Komisioni duhet të vendosë se si do të rrjedhë kjo çështje.

Haki Shatri – Nuk ka asgjë të keqe që nuk është ministri, sepse këtu janë përfaqësuesit e Ministrisë, që janë kompetentë dhe mund t’i mbrojnë pretendimet e Ministrisë.

Berim Ramosaj – E mbështeti z. Shatri. Nuk pati asgjë kundër që t’u jepej fjala përfaqësuesve të Ministrisë dhe të USAID-it.

Haxhi Gashi - USAID – Qëllimi i USAID-it nuk është të ndalet Projektligji për masat antidamping, por të jepet edhe një afat më i gjatë që të përpunohet më mirë. Për t’u përpunuar më mirë ky projektligj, duhet të bëhet ekspertizë e hollësishme për t’iu shmangur arbitraritetit, sepse dikush privilegjohet, ndërsa palët e tjera mund të diskriminohen. Ky projektligj më mirë është të mos miratohet së paku edhe pesë (5) vjet dhe të lejohet të funksionojë tregu i lirë si tani. USAID-i nuk po e zvarrit Projektligjin, por ekspertizën e vet po e jep në frymën që ligjet të jenë sa më të mira dhe të zbatueshme, sepse gati të gjitha projektligjet vijnë në Kuvend më mangësi të shumta. Kjo le të dyshohet se ka mungesë të kapaciteteve.

Izer Arifi - MTI-ja – Tha se i kupton shqetësimet e USAID-it, por sipas shkresës së tyre nuk ka argumente të fuqishme, meqë janë krijuar vetëm hipoteza, sepse gjithherë përdoret fjala “mund” dhe “do të ndodhe”. Nuk mund të pranohen pretendimet e tyre, sepse ky projektligj nuk i cenon të drejtat e askujt e më pak të biznesit. Përkundrazi e mbështet biznesin vendor. Po ashtu ceku nenin 47, që parashikon formimin e një komisioni që do të merrej me hetimin dhe me shqyrtimin e rasteve të shkeljeve të ligjit, sipas të cilit të gjitha palët udhëzohen në gjykatë për ta realizuar të drejtën e vet. Shtoi se nuk qëndron fakti se MTI-ja nuk ka kapacitete për ta nxjerrë një projektligj që e rregullon një fushë të caktuar. Kërkoj të organizohet një dëgjim publik, në të cilin do të ftoheshin MTI-ja, USAID-i dhe komuniteti i bizneseve. Ky do të ishte një rast i mirë për t’i ballafaquar argumentet.

Berim Ramosaj – E falënderoi USAID-in për mbështetjen deri më sot. Theksoi se qëndron argumenti i Ministrisë, sepse argumentet e ofruara nga UASID-i janë më të përgjithshme dhe jobindëse. E mbështeti idenë e Ministrisë për një debat më të gjerë, në të cilin do të harmonizoheshin qëndrimet e të dy palëve. Ky projektligj mbron biznesin vendor dhe duhet të mbështetet sa më tepër ky biznes, sepse me këtë politikë do të krijohet një politikë kombëtare dhe do të faktorizohet biznesi vendor.

Haki Shatri – Theksoi se konceptualisht duhet të ekzistojë një ligj i tillë, me të cilin do të mbroheshin prodhimi dhe biznesi vendor. Një ligj të tillë e ka tërë rajoni. Duke iu referuar qëndrimit të USAID-it, tha se edhe ai e mbështet në parim një ligj të tillë, por ka rezerva, edhe pse mund të përgatitë versione konkrete dhe t'i sjellë në Komision, në mënyrë që të harmonizohen qëndrimet.

Ethem Çeku – I ftoi të dy palët të ulen dhe t'i harmonizojnë qëndrimet. Duhet të ftohen edhe palët e tjera, nëse ka dhe të nxirret një ligj sa më i mirë. Ky është qëndrim edhe i USAID-it, sepse ka ligje të miratuara, mirëpo ende pa nisur zbatimin e tyre, duhet të bëhen plotësime dhe ndryshimet në to.

Sala Berisha – Shala – Theksoi se të dyja palët nuk janë shumë larg në koncepte. Propozoi të organizohet një dëgjim publik, sepse edhe propozimi i USAID-it për ta shtyrë miratimin e tij edhe për pesë (5) vjet, është jokorrekt.

Haxhi Gashi (USAID) – Janë dy çështje që nuk mund të miratohet ky projektligj: *e para* - sepse janë dymbëdhjetë (12) projektligje, për të cilat asiston UASID-i më ekspertë, që nuk mund të përballohen as fizikisht; *e dyta* - sepse ky projektligj nuk mund të zbatohet, meqë edhe në Shqipëri është miratuar një i tillë dhe ka dështuar. Po ashtu nuk mund të lejohet që me një projektligji, dikujt t'i krijohen benefite e dikush të diskriminohet.

Pas debatit të gjerë Komisioni njëzëri nxori këtë

Përfundim

- I. Të realizohet një takim ndërmjet MTI-së dhe USAID-it, pastaj në një afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh, t'i harmonizojnë qëndrimet dhe Komisionit t'ia paraqesin komentet e tyre.

Të vazhdohet edhe për dy javë bashkëpunimi në mesë Komisionit për ETIETT, të MTI-së si dhe të Zyrës ligjore të USAID-it me qëllim të amendamentimit sa më cilësor të P/ligjit, në funksion të mbrojtjes dhe realizimit të qëllimit të Ligjit.

IV. Shqyrtimi i Projektligjit për zonat ekonomike

Kryetarja – Kërkoj nga raportuesi i këtij projektligji ta paraqiste raportin më amendamente për këtë projektligj.

Haki Shatri – Ia paraqiti Komisionit raportin me amendamente për Projektligjin për zonat ekonomike. Theksoi se kanë ekzistuar dy dilema: *e para* - sa i përket çështjes së shfrytëzimit të pronës për nëntëdhjetë e nëntë (99) vjet dhe *e dyta* - vendimi për zonat ekonomike - kompetente për disa nene është Ministria kurse për disa Qeveria.

Berim Ramosaj – Kërkoj të mos personalizohet Ministria, sepse në shumë nene është cekur se prerogativat e Ministrisë ia kanë lënë ministrit.

Sala Berisha – Shala – Kërkoj të riformulohen amendamenti 14, i organit të shqyrtimit dhe amendamenti 18 - të sqarohet koncepti i zhvillimit të zonës ekonomike.

Pas diskutimit të gjerë Komisioni nxori këtë

Përfundim

- I. Miratohet Raporti me amendamente për Projektligjin për zonat ekonomike, me vërejtjet e paraqitura.

V. Të ndryshme

a) Çështje vijuese

Kryetarja – Kërkoj nga anëtarët e Grupit të Punës për shqyrtimin e Planit të Veprimit, të mblidhet dhe ta përfundojë një raport për këtë çështje. Po ashtu kërkoj nga z. Çeku ta aktivizojë Grupin e Punës për Projektligjin për gazin natyror dhe nga z. Shatri për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për derivate të naftës.

Sala Berisha – Shala – Kërkoj të përfshihen të gjithë anëtarët e Komisionit në grupe pune për shqyrtimin e projektligjeve, sepse disa prej tyre janë lënë anash ose janë pasivë.

Safete Hadergjona – Kërkoj të përcaktohet një herë e mirë a do të punohet vetëm me nga një raportues për projektligj apo të formohen grupet pune për të cilat do të përcaktohet nga një referues për grup.

Mbledhja përfundoi në orën 13:00.

Kryetare e Komisionit

Myzejene Selmani